



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYEMINISTRIA
AGJENCIA PËR DIALOG DHE BASHKËQEVERISJE

Referuar kërkesës për informacion drejtuar Koordinatorit për të Drejtën e Informimit më datë 10.08.2026 nga Z. Zef Ndoka bëjmë me dije si vijon:

Çështja është regjistruar në Platformën e Bashkëqeverisjes me nr. 937351, datë 22.04.2026, nga z. Zef Ndoka, me objekt kërkesën për informacion lidhur me ankimin administrativ të kryer pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Kadastrës në lidhje me veprimet dhe mosveprimet e kryera nga ASHK Lezhë-Mirditë-Kurbin për refuzimin e kryerjes së shërbimeve Kadastrale.

Pas verifikimit paraprak të ankesës dhe dokumentacionit bashkëlidhur, bazuar në pikën 1 të nenit 40 të ligjit nr. 107/2021 “Për Bashkëqeverisjen”, në datën 22.04.2026 është kryer delegimi i rastit pranë ASHK-së, Drejtoria e Përgjithshme. Në të njëjtën datë, kjo e fundit ka informuar se ankesa e sipërcituar e ngarkuar në platformën e Bashkëqeverisjes nuk është në kushtet e trajtimit si ankim administrativ nga ky institucion.

Pas marrjes së përgjigjes nga ASHK Drejtoria e Përgjithshme, po në datën 22.04.2026 qytetarit i është dërguar kthim përgjigje në lidhje me trajtimin e ankimit administrativ pranë ASHK Drejtoria e Përgjithshme.

Më datë 25.05.2026, qytetari rihap ankesën duke informuar se ka kryer më datë 23.04.2026 dërgimin e ankimit administrativ pranë ASHK Drejtoria e Përgjithshme me anë të shërbimit postar por nuk ka marrë përgjigje në lidhje me trajtimin.

Më datë 02.06.2026, qytetari informohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Kadastrës, nëpërmjet platformës së Bashkëqeverisjes se në kuadër të vijimit të ankimit administrativ pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Kadastrës, nuk rezulton i depozituar në mënyrë shkresore dhe postare, fotokopje e dokumentit të identifikimit të qytetarit sikundër i është bërë me dije në kthim përgjigjen që ky institucion i ka dërguar qytetarit.

Më datë 10.06.2026 qytetari rihap ankesën në platformën e Bashkëqeverisjes duke informuar se "Me datë, 03.06.2026 ora 16:44 është realizuar postimi dhe ka mbërritur në institucion me datë, 05.06.2026 ora 15:27" dhe po në datë 10.06.2026 në kuadër të ndjekjes së ankesës së qytetarit nëpërmjet platformës së Bashkëqeverisjes, duke respektuar afatet ligjore të ankimit administrativ referuar ligjit 111/2018 " Për Kadastrën " dhe Kodit të Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë është bërë dërgimi i këtij informacioni të dhënë nga qytetari, pranë ASHK Drejtoria e Përgjithshme nëpërmjet platformës së Bashkëqeverisjes.

Në datën 25.06.2026 qytetari është informuar nëpërmjet platformës së Bashkëqeverisjes, pasi po në datën 25.06.2026 ASHK Drejtoria e Përgjithshme ka kthyer përgjigje në platformën e Bashkëqeverisjes se: "Ankimi i subjektit Zef Ndoka është në punim, në zbatim të Ligjit Nr. 44/2015 neni 91 të Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë."

Më date 7.7.2026 qytetari informohet nëpërmjet platformës së Bashkëqeverisjes në lidhje me komunikimet shkresore drejtuar Drejtorisë Vendore ASHK Lezhë dhe ASHK Lezhë-Mirditë-Kurbin nga platforma e Bashkëqeverisjes për trajtim.

Më datë 14.8.2026 qytetarit i është dërguar nëpërmjet platformës së Bashkëqeverisjes, shkresa Kthim Përgjigje nga ASHK Lezhë Mirditë Kurbin me nr. prot 3655/1 datë 11.8.2026 në lidhje me objektine tij të ankesës e sigluar elektronikisht nga Drejtori i ASHK Lezhë Mirditë më datë 13.8.2026.